

KARTA
PËR PËRFAQËSIM
TË BARABARTË GJINOR
NË STRUKTURAT VENDIMMARRËSE
NË ZONAT RURALE

Tiranë, Gusht 2013





© Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti
Tiranë, Shqipëri, Gusht 2013

Ky botim u përgatit nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti. Përgatitja dhe publikimi i tij u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të Instrumentit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Punoi: Etleva Bisha (MA)
Blerina Guga

Redaktimi dhe
përgatitja grafike: Elona Kapexhiu

PERMBAJTJA

i.	HYRJE	5
I.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT MBI PJESËMARRJEN DHE PËRFAQËSIMIN E BARABARTË NË VENDIMMARRJE	7
II.	SITUATA E GRUAS NË ZONAT RURALE	9
III.	REKOMANDIME PËR VENDIMMARRËSIT PËR RRIJTJEN E PËRFAQËSIMIT TË GRUAS NË ZONAT RURALE	13
	1. PARTITË POLITIKE	13
	2. AUTORITETET VENDORE	13
	3. SHOQËRIA CIVILE	14
	4. MEDIA	14
IV.	KËSHILLA PËR GRATË QË TË KAPËRCEJNË PENGESAT E TË BËHEN PJESË AKTIVE E VENDIMMARRJES	15
V.	HISTORI SUKSESI DHE MESAZHE	16



HYRJE

Karta për Përfaqësim të Barabartë Gjinor në Strukturat Vendimmarrëse në Zonat Rurale është produkti final i punës me Forumin e Grave Drejtuese për gratë nga zonat rurale.

Forumi i Grave Drejtuese u ngrit si pjesë e një iniciative që Partnerët Shqipëri në partneritet me Shoqatën e Komunave të Shqipërisë zbatuan nga Qershor 2011-Shtator 2013, e cila synoi mbështetjen dhe fuqizimin e grave në zonat rurale, drejt një përfaqësimi dhe pjesëmarrje të barabartë, jo vetëm në proceset dhe strukturat vendim-marrëse, por edhe në fushat e tjera të jetës publike dhe private.

Iniciativa u mbështet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë.

Forumi i Grave Drejtuese për zonat rurale prej 24 anëtarësh, ka në përbërjen e vet të vetmen kryetare komune në vend, 2 nënkryetare të komunave, anëtare të këshillave komunarë, dhe përfaqësuese të strukturave organizative të partive politike në nivel lokal.

Ky Forum u asistua nga Partnerët Shqipëri dhe ekspertë të çështjeve gjinore për hartimin e Kartës për Përfaqësim të Barabartë Gjinor në Strukturat Vendimmarrëse në Zonat Rurale dhe rritjen e kapaciteteve të tyre lidhur me kuadrin ligjor dhe rregullator dhe mekanizmat institucionalë për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në strukturat vendimmarrëse, mekanizmat e pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale, teknika dhe mekanizma mbi advokasinë dhe lobimin, komunikimin me median dhe publikun, lidhësin dhe këshilla praktike mbi zhvillimin profesional etj.

Karta për Përfaqësim të Barabartë Gjinor në Strukturat Vendimmarrëse në Zonat Rurale u hartua të shërbejë si udhërrëfyes dhe motivues për gra dhe vajza në zonat rurale, që të jenë më aktive në jetën e komuniteteve të tyre, si dhe t'u paraqesë aktorëve kyç sugjerime dhe rekomandime për të përkrahur dhe promovuar pjesëmarrjen e gruas në shoqëri, veçanërisht në zonat rurale. Ky dokument është një mjet advokimi për t'u përdorur në çdo fushatë lobuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe përfaqësimin e tyre në politikë dhe në jetën shoqërore të komuniteteve ku punojnë e jetojnë.



PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT MBI PJESËMARRJEN DHE PËRFAQËSIMIN E BARABARTË NË VENDIMMARRJE

Pjesëmarrja politike e grave mundësohet përmes tre të drejtave kyç për gratë: të drejtën e grave për të votuar, për të kandiduar dhe për të marrë pjesë/përfaqësuar në vendimmarrjet publike (gruaja e zgjedhur në funksione publike). E drejta e grave për të marrë pjesë në jetën politike garantohet në legjislacionin kombëtar dhe në një numër Konventash ndërkombëtare:

Konventa¹ mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar nga Kombet e Bashkuara në 1979, specifikon:

Neni 7

Palët shtete duhet të marrin masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe, në mënyrë të veçantë, duhet t'u garantojnë grave, mbi baza të barabarta me burrat, të drejtën:

- a. të votojnë** në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike dhe të jenë të ligjshme për t'u zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publikisht;
- b. të marrin pjesë në formulimin e politikave qeverisëse** dhe në zbatimin e tyre dhe për të mbajtur poste publike dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- c. Të marrin pjesë në organizatat jo-qeveritare dhe shoqatat që merren me jetën publike dhe politike të vendit.**

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut²: Neni 21 i kësaj Deklarate përcakton se: "**kushdo** ka të drejtë të marrë pjesë në qeverinë e vendit të tij, drejtpërsëdrejti ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht".

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e Kombeve të Bashkuara. Neni 25 i saj i jep **çdo shtetasi, pa diskriminim**, të drejtën e votës dhe të garimit për funksione publike.

Shqipëria ka një paketë të gjerë ligjore në këndvështrimin e çështjeve të barazisë gjinore:

Ligji "**Për barazinë gjinore në shoqëri**";³ nr. 9970 datë 24.07.2008 në këndvështrimin e përfaqësimit të grave ligji specifikon: "të paktën 30% e pozicioneve të emëruara duhet të plotësohen nga gjinia e nënpërfaqësuar-gratë".

¹ <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm#article7>; Konventa CEDAW u ratifikua nga Shqipëria përmes Ligjit 1769, datë 9.11.1993 dhe në vitin 2003 Shqipëria ratifikoi edhe Protokollin Opsional të saj.

² <http://www.un.org/en/documents/udhr/>

³ Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".



Kodi Zgjedhor⁴ (Dhjetor 2008 rishikuar në 2012): Neni 67, pika 6. “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi”.

⁴ http://www.parlament.al/web/Kodi_zgjedhor_i_Republikes_se_Shqiperise_5073_1.php

SITUATA E GRUAS NË ZONAT RURALE

Është fakt i njohur tashmë që në Shqipëri niveli i përfaqësimit të gruas në strukturat vendimmarrëse, të zgjedhura si kryetare bashkish e komunash, në këshillat bashkiakë e komunarë apo drejtuese në administratën vendore, vijon të mbetet i ulët.

Shqipëria ka shembuj të grave në pozicione kyçe vendimmarrëse të tilla si: Kryetare Parlamenti, Kryetare e Gjykatës së Lartë, Prokurore e Përgjithshme, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj. Momentalisht, në kabinetin qeveritar mban post ministror 1 grua ose 7,1 % e kabinetit dhe postin e zv/ministrit 8 femra, nga 35 gjithsej, ose 22,8%.

Gratë që mbajnë funksione të tilla të rëndësishme shërbejnë si modele pozitive dhe prania e tyre në këto pozicione është rezultat i një rruge të gjatë drejt ndryshimit të qëndrimeve ndaj kapacitetit të grave për të udhëhequr.

Në qeverisjen vendore, fatkeqësisht përfaqësimi i grave është më i ulët. Referuar rezultateve të zgjedhjeve të fundit vendore, rezulton se nga 65 bashki, tre prej tyre ose 7.7% drejtohen nga gra. Në listat për kandidatë për këshillat bashkiakë u respektua kuota gjinore prej 30%, por nga 872 kandidatë për kryetarë këshillash vetëm 14 ishin gra dhe në fund u zgjodhën vetëm gjashtë.⁵

Kjo është situata aktuale e përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, si në nivel qendror edhe atë vendor. Nuk gjenden të dhëna zyrtare mbi administratat e komunave e aq më pak për gratë dhe vajzat në pozicionet drejtuese në komuna apo këshillat komunarë.

Gjatë punës me Forumin e Grave Drejtuese për zonat rurale, u mblodhën të dhënat e mëposhtme mbi situatën gjinore në administratat dhe këshillat komunarë të komunave e tyre: *(vijon në faqen tjetër)*

⁵ ACER, ASET, 2010. "The situation of Women leaders at the Local level in Albania, A Baseline Analysis", fq. 43. Online: <http://platformagjinore.al/wp-content/themes/theme1369/pdf/Studim%20mbi%20Situaten%20ne%20Shqiperi%20te%20Grave%20ne%20Nivel%20Vendor%20UNWOMEN%20ACER%20eng.pdf>



KOMUNA	DREJTUESE NË ADMINISTRATË	ANËTARE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS	DREJTUESE TË KOMUNËS
GJERGJAN	42%	20% (3 gra nga 15 anëtarë)	Kryetare
NDROQ	80%	27% (4 gra nga 15 anëtarë)	Nënkryetare
MOLLAJ	52%	7% (1 grua nga 15 anëtarë)	Nënkryetare
KOZARE	12%	7% (1 grua nga 15 anëtarë, Kryetare e këshillit)	
XHAFZOTAJ	75%	12 % (2 gra nga 17 anëtarë)	
KASHAR	13%	0% (asnjë grua nga 25 anëtarë)	
VËRTOP	67%	7% (1 grua nga 15 anëtarë)	
PETRAN	50%	8 % (1 grua nga 13 anëtarë)	
NOVOSELË	63%	12% (2 gra nga 17 anëtarë)	
ULËZ	12%	30% (4 gra nga 13 anëtarë)	
BICAJ	0%	0% (asnjë grua nga 15 anëtarë)	
SHISHTAVEC	22%	7% (1 grua nga 15 anëtarë)	
HU DENISHT	50%	0% (asnjë grua nga 15 anëtarë)	
BUSHAT	50%	4% (1 grua nga 25 anëtarë)	
SHUSHICË	30%	6% (1 grua nga 17 anëtarë)	
SHËNKOLL	30%	12% (2 gra nga 17 anëtarë)	

Ne gjykojmë se kjo situatë e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrjet lokale është pasojë e:

- Partitë politike** nuk i përfshijnë sa duhet gratë në listat e kandidatëve për anëtar të këshillit të komunës. Pra ato nuk respektojnë ligjin për kuotën gjinore.
- Shpesh mungon **ambicia e grave** për të kandiduar, por kjo kryesisht për shkak të ambientit të vështirë që gjejnë në parti politike politike nga

njëra anë dhe mentalitetit të komunitetit nga ana tjetër. Komunitetet në zonat rurale rëndom e konsiderojnë politikën “një profesion për burra dhe jo për gra”. Megjithatë, mungesa e ambicies është e kombinuar edhe me mungesën e besimit nga gratë tek kapacitetet dhe aftësitë individuale fituese, mungesa e modeleve të suksesshme në politikë, si dhe mungesa e trajnimeve dhe niveli i formimit politik. Duam gjithashtu të theksojmë se presioni politik dhe klima tejet e polarizuar politike ndikon negativisht në ambicien e grave për t’u përfshirë aktivisht në politikë, së bashku me burimet e kufizuara financiare të grave që janë një tjetër faktor që e frenon ambicien e tyre për të kandiduar.

3. **Familja** gjithashtu kthehet në një faktor frenues për shkak të mbështetjes së munguar, duke mos i ndarë detyrat dhe përgjegjësitë familjare në mënyrë të barabartë e duke mos krijuar hapësirat e nevojshme që një grua t’i kushtojë kohë edhe angazhimeve politike e publike.
4. **Mungojnë iniciativat për promovimin e gruas në politikë në zonat rurale.** Duam të theksojmë mungesën e vëmendjes së duhur në drejtim të përfaqësimit politik të gruas në zonat rurale edhe nga aktorë jo shtetërore, shoqëri civile dhe media.
5. **Autoritetet vendore, me pak përjashtime, nuk përdorin mekanizma që nxisin përfshirjen e grave të komunitetit në procesin e marrjes së vendimeve që ndikojnë mbi jetën e tyre.** Ekzistenca dhe zbatimi i këtyre mekanizmave në parim do t’i mundësonte grave t’i adresonin nevojat dhe prioritetet e tyre vazhdimisht tek autoritetet vendore, këtyre të fundit do t’u krijonte mundësinë që t’i orientonin burimet lokale (sado të kufizuara) në përputhje me këto nevoja dhe prioritete. Ne identifikua shumë pak raste praktikash të tilla të zbatuara në komunat që përfaqësojmë, por edhe atje ku ato janë ngritur (për shembull Komuna Kashar) ka ende një nivel të ulët të pjesëmarrjes së grave për shkak të mungesës së kuptimit të qartë të vlerës dhe produktit të procedurave të tilla.
6. **Gratë e zgjedhura në Këshillin e Komunave** jo gjithmonë e ngrënë zërin sa duhet për të kërkuar më shumë reagim nga autoritetet në adresimin e nevojave dhe prioritetëve të grave, ndërkohë që ato bashkëpunojnë pak ose aspak me njëra-tjetrën përtej spektrit partiak.

Ndërkohë ne duam të nënvizojmë fort faktin se sfidat që ndeshin gratë në zonat rurale janë të shumëfishta:

1. **Sfidat ekonomike:** Vetë punësimi në fshat nuk funksionon sepse tokat mbeten të papunuara për shkak të çmimit të lartë të naftës, farërave dhe pesticideve. Pasiguria e tregut të shitjes së produkteve, mungesa e sistemeve të ujitjes dhe kullimit janë gjithashtu faktor që kontribuojnë negativisht. **Niveli i ulët arsimor** (tetëvjeçar dhe i mesëm) dhe



jo i profilizuar sipas nevojave të zonave rurale është një pengesë e rëndësishme për punësimin e gruas në zonën rurale. **Varfëria** në zonat rurale adresohet në minimumin jetik pasi llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së tokës. Ligji i ndihmës ekonomike është në disfavor të këtyre familjeve: një familje e varfër merr maksimumi 5 mijë lekë në muaj, por në shumicën dërmuese të rasteve familjet e varfra marrin 1500 lekë/muaj. Ndërkohë sfida që ndeshin gratë e punësuara: pasiguria e vendit të punës për arsye politike!!! Për më tepër, mungojnë iniciativat nga autoritetet vendore për nxitjen e formave të punësimit alternativ tek gratë në zonat rurale.

2. **Dhuna në familje:** Është shumë e fshehur në zonat rurale për shkak të mentalitetit dhe varësisë tejet të madhe ekonomike nga burrat. Madje, për shkak të mentalitetit ka pasur dhe ka gra të zonave rurale që kanë përjetuar dhunën të cilat i kanë dhunë fund jetës në mënyrë tragjike si e vetmja rrugë për të shpëtuar nga dhuna!!! Përballë dhunës të fshehur brenda familjes dhe mentalitetit, reagimi nga institucionet shtetërore dhe jo qeveritare është pothuajse inegzistent në zonat rurale.
3. **Të izoluara nga jeta sociale dhe kulturore:** Kjo për shkak të mungesës së çfarëdolloj iniciative të ndërmarrë si nga autoritetet vendore ashtu edhe nga organizata të shoqërisë civile.
4. **Infrastruktura lokale:** çerdhet mungojnë, kopshtet ofrojnë shërbim me kohë shumë të kufizuar. Shërbimi shëndetësor ka mungesa të mjekëve dhe infermierëve, mungojnë ambulancat, mungon shërbimi 24 orësh, mungon shërbimi i urgjencës. Siguria: policia në numër të ulët, ndriçimi lokal i keq ose shumë i keq, infrastruktura rrugore shumë e keqe.



REKOMANDIME PËR VENDIMARRËSIT PËR RRRITJEN E PËRFAQËSIMIT TË GRUAS NË ZONAT RURALE

Duke e konsideruar tejet të rëndësishëm ndryshimin e situatës dhe rritjen e përfaqësimit të gruas në zonat rurale, u rekomandojmë aktorëve vijues:

1. PARTIVE POLITIKE

- **Respektoni kuotën gjinore** për të garantuar që minimalisht një në tre vendet e para të listës të jetë grua. *Klauzolat e gjobës në vend të garantimit të grave në pozicionet fituese të listës nuk duhet të ekzistojnë.*
- Në statutet tuaja parashikoni vendosjen e **kuotës gjinore për funksione drejtuese brenda forcës politike.**
- **Mekanizmat e përzgjedhjes së kandidatëve** të jenë të mirëpërcaktuara, të qarta dhe të respektojnë demokracinë e brendshme dhe **të krijojnë shanse të barabarta** të konkurrimit apo përfshirjes në listën e kandidatëve.
- Ndërmerrni **veprime konkrete për të promovuar gruan në politikë në zonat rurale**, përmes nxitjes së kandidimit të tyre, mbështetjes së grave që punojnë me komunitetin dhe nxitjes së tyre për të përfaqësuar komunitetin në vendimmarrje.
- Ndërmerrni trajnime apo iniciativa të tjera që synojnë **ngritjen e kapaciteteve të grave të përfshira në politikë në zonat rurale.**
- Ndërmerrni **iniciativa që kontribuojnë në ndryshimin e mentalitetit të komuniteteve lokale** (pra të kontribuojnë në edukimin e komuniteteve për rolin që duhet të luajë gruaja në shoqëri) që e konsiderojnë politikën si një profesion burrash dhe jo edhe grash.
- **Forumet politike të grave** duhet të ndërgjegjësojnë gratë, t'i informojnë për pjesëmarrjen dhe të kërkojnë nga partitë politike jo vetëm të respektojnë ligjin për kuotën, por edhe të adresojnë në programet e tyre politike çështje që lidhen me gratë në zonat rurale. **Roli i tyre duhet të jetë përcaktues në përfaqësimin e grave brenda strukturave partiake dhe në funksione publike** (të zgjedhura).

2. AUTORITETEVE VENDORE

- **Ruani balancën gjinore në funksionet drejtuese**, duke mundësuar drejtimin si nga burrat dhe nga gratë bazuar në kapacitetet dhe eksperiencat më të mira.



- Drejtuesit vendor dhe Këshilli i Komunës të respektojnë ligjin në këndvështrimin e këshillimit me komunitetin, pra edhe me gratë e të ndërtojnë mekanizma që u krijojnë hapësirën dhe mundësitë grave të komunitetit të adresojnë vazhdimisht nevojat dhe prioritetet e tyre, si dhe t'i orientojnë burimet lokale në përputhje me kërkesat e grave.
- Në hartimin dhe zbatimin e politikave lokale jini të orientuar drejt adresimit të nevojave të grave të komunitetit e në mënyrë të veçantë të adresimit të çështjeve të punësimit të grave, të varfërisë, infrastrukturës lokale në këndvështrimin e prioriteteve gjinore, dhunës ndaj gruas, nxjerrjes së grave nga izolimi social dhe kulturor, etj.
- Nxisini shoqatat që operojnë në komuna për përfaqësimin e grave në anëtarësi, bordet drejtuese si dhe në ndërmarrjen e iniciativave që nxisin punësimin e grave.

3. SHOQËRISË CIVILE

- **Kthejini sytë nga gratë në zonat rurale** me iniciativa konkrete që nga njëra anë adresojnë situatën e nënpërfaqësimit të gruas në vendimmarrje në zonat rurale e nga ana tjetër adresojnë sfida të tilla si papunësia, dhuna, izolimi social etj.
- Kontribuoni në **ngritjen e kapaciteteve të grave në zonat rurale** për t'i krijuar shanset që të konkurrojnë në mënyrë të barabartë me burrat.
- **Monitoroni e rrisni presionin mbi partitë politike** për të rritur përfaqësimin e gruas në vendimmarrjet lokale.
- Ndërmerrni **iniciativa për edukimin e votuesve dhe ndryshimin e mentalitetit të komuniteteve në zonat rurale** për pjesëmarrjen e gruas në politikë.

4. MEDIAS

- Promovoni **rolin dhe rëndësinë e përfaqësimit të grave nga zonat rurale** në vendimmarrje.
- Promovoni **histori suksesi** që nxisin ambicien dhe besimin e grave të tjera.
- Kontribuoni në **edukimin e votuesve dhe ndryshimin e mentalitetit**.
- **Jepini hapësirë dhe zë grave që jetojnë në zonat rurale** për të adresuar sfidat që ndeshin në jetën e përditshme e duke ndikuar kështu në rritjen e vëmendjes së politikëbërësve ndaj nevojave të grave në zonat rurale.

KËSHILLA PËR GRATË QË TË KAPËRCEJNË PENGESAT E TË BËHEN PJESË AKTIVE E VENDIMMARRJES

Mos prisni t'ju kërkojnë mendim, por ndërmerrni iniciativën për të ndikuar në vendimmarrje!

Besoni tek vlerat, forca dhe produkti që ju mund t'i ofroni politikës apo njësive vendimmarrëse. Mos prisni të ngrënë zërin të tjerët për ju, por luftoni për të drejtat tuaja. Përpiquni vazhdimisht të ngrini kapacitetet tuaja dhe të ofroni më të mirën në shërbim të komunitetit.

Ndani rolet, detyrat dhe përgjegjësitë, e siguroni mbështetje brenda familjes!

Familja është një faktor i rëndësishëm në drejtim të nxitjes së gruas për të qenë pjesë e vendimmarrjeve politike e publike. Angazhime të tilla ndër të tjera kërkojnë kohë, e për rrjedhojë është e domosdoshme që detyrat e përgjegjësitë familjare të jenë të ndara në mënyrë të barabartë.

Përfshihuni dhe angazhohuni në parti politike!

Përmes partive politike kalon përfaqësimi politik i gruas. Partitë politike reagojnë më shumë dhe bëjnë ndryshime kur presioni për përfaqësim më të madh të gruas vjen nga brenda forcës politike. Padyshim që kjo mund të ndodhë kur gratë janë të organizuara në mënyrë të efektshme dhe e kanë objektiv parësor përfaqësimin e tyre në strukturat brenda partisë dhe vendimmarrjet politike publike. Mos hezitoni të merrni detyra dhe përgjegjësi specifike brenda partive politike dhe të ngrini zërin kur çështjet e gruas nuk adresohen sa dhe si duhet.

Përfshihuni në angazhime komunitare që krijojnë besimin dhe mbështetjen e komunitetit!

Punoni me dhe për komunitetin. Puna dhe shërbimi për komunitetin është mbështetja më e mirë për t'ia dalë e për të qenë pjesë e vendimmarrjes.

Adresoni çështje të barazisë gjinore!

Si pjesë e këshillave të komunave gratë e zgjedhura mund të kontribuojnë realisht në adresimin e nevojave dhe prioritetëve të grave të zonave rurale nga autoritetet lokale. Ndër të tjera kjo kërkon bashkëpunim mes vetë grave të zgjedhura, pavarësisht se cilën forcë politike përfaqësojnë ato në këshill.

Suksesi juaj shërben si model për gra të tjera!

Një grua e suksesshme frymëzon të tjera gra. Prandaj kur punoni si drejtuese apo si e zgjedhur mbani premtimet që bëni, punoni me këmbëngulje e vullnet, jini e dukshme dhe e hapur: informuese, transparente, llogaridhënëse. Punoni me profesionalizëm dhe shfaqni paanësi politike në ushtrimin e detyrave publike.

HISTORI SUKSESI DHE MESAZHE

“Komunikimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm me komunitetin, kyçi i suksesit për të zgjedhurit vendor”

**Erjeta Alhysa, 42 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve,
Zv/Kryetare e Komunës Ndroq,
Kryetare e PS për Komunën Ndroq,
Anëtare e Asamblesë Kombëtare të PSSH.**



Modeli udhërrëfyes për mua në politikë ka qenë mamaja ime, një grua që i shërbeu komunitetit të komunës Ndroq në fillim si përgjegjëse sektori e më pas si Kryetare e komunës. Kam marrë prej saj forcën për të sfiduar vështirësitë dhe vullnetin për t'i gjetur zgjidhjet përmes komunikimit e ndërveprimit me vetë komunitetin për të cilin punoj çdo ditë. Në rrugën time në politikë kam patur gjithnjë mbështetjen e familjes, por edhe të komunitetit i cili në fillim më njihte si mësuese, por që prej 2007 më njeh e më mbështet edhe si aktiviste e drejtuese vendore. Sot jam krenare që komuna Ndroq është ndër të paktat komuna në Shqipëri ku 80% e drejtuesve të administratës janë gra. Mund të them pa hezitim se niveli i lartë i grave në pozicionet vendimmarrëse ka zbutur konfliktualitetin politik, ka rritur tolerancën dhe padyshim ka ndikuar në cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrohen jo vetëm komunitetit në përgjithësi, por edhe grave në veçanti.

“Vetëm me punë, këmbëngulje, vullnet dhe duke u rritur vazhdimisht profesionalisht mund të arrini atje ku aspironi”

**Suzana Gjyzeli, 50 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy vajzave,
Drejtuese e Zyrës së Tatim-Taksave në Komunën
Xhafzotaj,
Anëtare e Partisë Demokratike.**



Kam 30 vjet që ushtroj profesionin tim, nga të cilat 10 vite si drejtuese e Zyrës së Tatim-Taksave. Përveç arsimit të kryer nuk kam rreshtur së plotësuari e përmirësuar njohuritë e mia jo vetëm në fushën ekonomike dhe juridike, por edhe në këndvështrimin e çështjeve të barazisë gjinore. Çdo profesion ka

sfidat e tij, por sfida më e madhe që kam ndeshur kanë qenë politike: çdo parti që ka marrë mandatin për të drejtuar komunën ku punoj ka kërkuar të më “lëvizë” nga vendi i punës. Kam arritur të vijoj sepse kam ngritur zërin dhe kam mbrojtur të drejtën time për të mbajtur vendin e punës që e kisha arritur me sakrificë e me shumë punë dhe nuk ma kishte dhuruar askush. Për fat të keq ende partitë politike nuk shohin të aftin dhe specialistin, por militantin. Kjo duhet të marrë fund!

“E vështirë, por jo e pamundur të sfidosh mentalitetin”

**Elda Doçi, 26 vjeç,
bashkëshorte,
Përgjegjëse e Zyrës me një Ndalesë, Komuna
Bushat.**



Kur nisa punën në këtë Komunë sfida e parë për mua ishte mentaliteti i një komuniteti që i sheh gratë vetëm si shtëpiake. E ndjeva këtë jo vetëm në komunikimin me komunitetin gjatë ushtrimit të detyrës sime, por edhe nga realiteti që gjeta në administratën e komunës ku grua në drejtim ishte vetëm shefja e financës dhe nuk kishte asnjë grua anëtare të këshillit të komunës. Ajo që unë dua të bëj në vijim është që njohuritë e mia, të fituara edhe nga përfshirja në këtë forum t'i përhap përmes trajnimeve dhe të ndikoj mbi komunitetin dhe vendimmarrësit që kjo situatë e përfaqësimit të gruas në këtë komunë të ndryshojë. E di që është e vështirë, por jo e pamundur!

“Më shumë vëmendje nga institucionet për gratë vulnerabël”

**Merita Dollaku, 47 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy vajzave,
Administratore e ndihmës dhe çështjeve sociale në
Komunën Xhafzotaj.**



Prej vitesh kryej këtë detyrë në komunën Xhafzotaj e për rrjedhojë komunikoj vazhdimisht me banorë të kësaj komune. Më vjen keq që ndesh shumë shpesh gra që mjaftohen me martesën dhe krijimin e familjes dhe nuk luftojnë për arsimimin dhe të drejtat e tyre. Ndërkohë duke qenë vazhdimisht në kontakt me gra vulnerabël mund të them se ato përballen me papunësi të lartë, vështirësi ekonomike, mosintegrim në jetën komunitare, jetojnë në zona me infrastrukturë të papërshtatshme. Këto grupe kërkojnë shumë më tepër vëmendje nga institucionet shtetërore.



“Suksesi im brenda forcës politike i arritur përmes punës”

**Etleva Myftari, 43 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e tre fëmijëve,
Përgjegjëse e zyrës së financës në
Komunën Petran
Nënkryetare e Gruas e Partisë
Socialiste, Përmet.**



E ardhur në Përmet nga zonat rurale pakkush besonte se unë do t’ia dilja të isha pjesë e forumeve drejtuese të Partisë Socialiste. Kam punuar shumë, bashkë me anëtarë të tjerë të kësaj force politike dhe ia dola të isha pjesë e forumit drejtues të saj. Eksperiencën time e pasurova dhe e pasuroj vazhdimisht edhe me seminare e trajnime ku marr pjesë dhe gjithçka e re e mësuar përmes tyre më ka ndihmuar të përmirësoj cilësinë e punës. Të gjitha këto bashkë më çuan drejt suksesit dhe sot jam nënkryetare e Forumit të Gruas së rrethit të Përmetit. Nuk ka qenë gjithnjë e lehtë, përkundrazi. Kam ndjerë edhe diskriminim për shkak të gjinisë, edhe brenda vetë forcës politike, por i kam konsideruar sfida dhe kam ecur përpara. Unë mendoj se nga partitë politike kalon rruga për të ndikuar mbi vendimmarrjet, për t’u dhënë zë grave e për të nxitur vendimmarrësit që të adresojnë nevojat dhe prioritetet e tyre.

“Këshilli i Komunës është për mua parlamenti i vogël i banorëve të Novoselës, si dhe vendi ku unë bashkë me dy kolege të tjera jemi zëri i grave të këtij komuniteti”

**Matilda Beqo, 28 vjeç
Anëtare e këshillit të komunës Novoselë,
Kryer studime master për anglisht,
Drejtoare e Shkollës 9-vjeçare Novoselë,
Anëtare e Forumit të Gruas së Partisë Demokratike
Vlorë.**



Në këtë këshill vetëm 13% janë gra dhe sfida që ndeshim vazhdimisht ka të bëjë me faktin që sa herë ne ngremë zërin për vendime dhe çështje që janë në interes të grave, nuk gjejmë mbështetje nga anëtarët e tjerë të këshillit. Për të ndryshuar këtë situatë partitë politike duhet të rrisin përfaqësimin e grave në këshillat e komunave, por edhe në nivele vendimmarrëse brenda partive. Jo vetëm kaq, por edhe në përzgjedhjen e kandidatëve ato duhet të udhëhiqen nga cilësitë dhe vlerat që individi i ofron politikës.

“Gratë duhet të ndërtojnë një besim të fortë tek vetja, dhe veçanërisht gratë rurale duhet ta vlerësojnë më shumë veten dhe të guxojnë të dalin jashtë gardhit të shtëpive të tyre”

**Lumturie Hoxha, 41 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve,
Kryetare e Komunës Gjergjan,
Kryetare e LSI për Komunën Gjergjan.**



Ndihem e privilegjuar dhe në të njëjtën kohë më vjen keq që jam e vetmja grua në kreun e një komune në vendin tim. Gratë duhet të ndërtojnë një besim të fortë tek vetja, dhe veçanërisht gratë rurale duhet ta vlerësojnë më shumë veten dhe të guxojnë të dalin jashtë gardhit të shtëpive të tyre. Ato duhet t’i kundërvihen mentalitetit patriarkal duke u arsimuar, duke punuar jashtë shtëpisë dhe duke marrë pjesë në strukturat politike për të advokuar kështu më mirë për nevojat dhe interesat e tyre. Familja dhe komuniteti im kanë qenë mbështetësit më të fortë në rrugën time politike. Së bashku me bashkëshortin, aktivist i LSI, unë mendoj se përbëjmë një model të mirë për familjet dhe veçanërisht për gratë e komunës sonë që të guxojnë të ecin përkrah me bashkëshortët apo partnerët e tyre, pse jo edhe më përpara.

“Rritja e angazhimit të grave brenda partive politike, presion i shtuar mbi partitë për të respektuar kuotën gjinore”

**Adriana Dule, 32 vjeç, bashkëshorte,
Kryetare e Forumit të Gruas në PS
për komunën Udenisht.**



Nëna ime ishte shtytësja e parë drejt angazhimit tim në një forcë politike. Ndërkohë punoja si infermiere dhe më hoqën nga puna për shkak të bindjeve politike. Kjo ishte shtysa e dytë, edhe më e fortë se e para për t’u angazhuar shumë më aktivisht për të ndryshuar këtë realitet. Komunikimi me njerëzit dhe lidhja me ta më ka ndihmuar të jem e suksesshme dhe t’ia dal si drejtuese e Forumit të Gruas. Sfida më e madhe që kam ndeshur gjatë punës në drejtimin e këtij forumi është nxitja e grave të komunës për t’u përfshirë e për të qenë aktive në një forcë politike. Kjo për shkak të mentalitetit, mungesës së kohës së lirë dhe barrës së punëve të përditshme. Tjetër sfidë ka të bëjë me respektimin e kuotës gjinore që në fakt ne po e adresojmë duke rritur rolin e grave brenda forcës politike. Rezultati: Në dy vjet e gjysmë është rritur ndjeshëm numri i grave të anëtarësuara.



“E diplomuar në Itali, sot në shërbim të komunitetit të Kasharit”

**Irena Bendo, 32 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e një vajze,
Përgjegjëse e Zyrës Juridike në Komunën e Kasharit.**



I kam kryer studimet e larta në Itali dhe ndonëse e gjithë familja ime jeton në Itali vendosa të rikthehesha në Shqipëri e ta ndërtoja familjen time këtu. E di që kushdo që nis një punë të re ndeshet me sfida, por për mua ato kanë qenë të dyfishta. Nga njëra anë sfidat e një juristeje të re, e nga ana tjetër rrëzimi i barrierave të komunikimit me disa nga kolegët meshkuj dhe të tretët me të cilët punoja e punoj ende. Ata e konsideronin pozicionin tim si të përshtatshëm për burrat, por këmbëngulja ime në ushtrimin e detyrës me korrektesi dhe profesionalizëm ishin mënyra më e mirë për të thyer këtë mendësi. E dua shumë profesionin tim dhe më pëlqen t'i shërbej komunitetit jo vetëm si drejtuese e juriste, por edhe duke u përfshirë vullnetarisht në projekte lokale. Të ndihmosh të tjerët është një vlerë e shtuar dhe të bën t'i shohësh gjërat me pozitivitet!

I vetmi zë për gratë e Shishtavecit në Këshillin e Komunës”

**Ramadanie Belaj, 54 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e katër fëmijëve,
Anëtarë e Këshillit të Komunës Shishtavec
Kryetare e Forumit të Gruas së PD.**



Sfida më e madhe që ndesh në këshillin e Komunës është të qenurit i vetmi zë për gratë e kësaj komune në këshill. Përpiqem të flas gjithmonë në këshill për të drejtat e grave sidomos të grave në nevojë, të pastreha, nëna kryefamiljare etj. Kam kërkuar mbështetje për ta nga këshilli, edhe pse jo gjithmonë ia kam dalë. Punoj me grupe të grave nëpër lagje duke zhvilluar takime një herë në muaj. Kam ngritur zërin edhe brenda forcës time politike që gruaja të jetë më shumë e përfaqësuar në këshill. Gratë duhet të jenë më të angazhuara dhe të ngrënë zërin për të drejtat e tyre.

“Puna dhe mbështetja e familjes më kanë çuar drejt suksesit”

**Zana Shehu, 40 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve,
Kryetare e Forumit të Grave Demokratike të Komunës
Bicaj,
Kryetare e PD në fshatin Nang,
Anëtare e kryesisë së PD, dega Kukës.**



Jam angazhuar që në vitet '90 në politikë dhe në këto 23 vjet me shumë punë ia kam dalë që nga anëtare e thjeshtë të bëhem kryetare e degës së Partisë Demokratike për fshatin Nang ku janë 60 anëtarë burra dhe asnjë grua, të drejtoj Forumin e Gruas për komunën Bicaj, si dhe të jem një nga anëtarët e Kryesisë së PD për degën e Kukësit. Mbështetjen kryesore e kam gjetur tek bashkëshorti, bashkë kemi ndarë rolet brenda familjes në mënyrë të barabartë duke gjetur kështu kohën e nevojshme për t'iu përkushtuar edhe kësaj pune. Kam ndjekur një numër trajnimesh që më kanë ndihmuar të jem një drejtuese e suksesshme. Punoj vazhdimisht dhe përpiqem të nxis gratë, e veçanërisht ato të fshatit tim, që të thyejnë barrierat e mentalitetit e të angazhohen.

“Nga infermiere e suksesshme në kryetare të Këshillit të Komunës”

**Pashke Shpani, 54 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e pesë fëmijëve,
Kryetare e Këshillit të Komunës Ulzë,
Infermiere në Qendrën Shëndetësore.**



Nuk e kisha menduar kurrë më parë përfshirjen time në politikë. Shtysa për të kandiduar në zgjedhjet lokale të vitit 2011 erdhi nga koleget e punës dhe gra të komunitetit që njihnin punën dhe seriozitetin tim. Vendosa të kandidoj dhe mbështetja me votë e komunitetit më bëri kryetare të këshillit të komunës, ku katër nga anëtarët janë gra. Këshilli ynë është ndër të paktët jo vetëm për respektimin e kuotës gjinore, por edhe për faktin se anëtarët e këshillit na mbështesin kur ngremë apo diskutojmë çështje të grave të komunitetit. Madje edhe zgjedhja ime si drejtuese e këtij këshilli, ku gratë përbëjnë vetëm 30%, është tregues i kësaj mbështetje.

“Burime lokale shumë të kufizuara kundrejt nevojave të grave të komunitetit”

**Liza Rica, 54 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e tre fëmijëve,
Sekretare e këshillit të komunës Ulzë.**



Në pozicionin e sekretares së këshillit të Komunës Ulzë jam vazhdimisht në kontakt me komunitetin dhe me gratë. Gjendja ekonomike e tyre është shumë e rëndë dhe burimet lokale janë shumë të kufizuara. Është e domosdoshme një mbështetje më e madhe dhe reale për nevojat e grave në zonat rurale në përgjithësi dhe në komunën tonë në veçanti.

“Të thyesh stereotipet gjinore në punësim”

**Dafina Davidhi, 28 vjeç,
Shefe e policisë në Komunën Novoselë.**



Prej disa muajsh drejtoj njësinë e vogël të policisë së komunës Novoselë. E kam patur gjithnjë pasion policinë dhe kur drejtuesi i komunës më propozoi këtë pozicion, e pranova pa hezitim. Familja ime ishte e para që u surpriza, ndërsa banorë të komunës shpesh më ironizonin. Sfida ime ishte sa me komunitetin, aq edhe me dy vartësit e mi policë të cilët e kanë të vështirë të drejtohen nga një grua. Nuk e fsheh, ka pasur raste që jam ndjerë në siklet por kam gjetur mbështetjen e drejtuesit të komunës. Tani janë mësuar me pamjen time me uniformë policie dhe unë dua të vijoj me ëndrrën time. Komuniteti ndërkohë ka kuptuar se prezenca ime po e zbut klimën e konfliktualitetit.

“Akses të barabartë në shërbime”

**Evisa Hoxha, 25 vjeç,
Administratore e ndihmës ekonomike dhe punonjëse
sociale në Komunën Vërtop.**



Edhe pse nuk kam eksperiencë të gjatë në këtë detyrë, ç’ka vihet re është fakti se në zyrat tona drejtohen vetëm burrat dhe jo gratë. Largësia nga komuna bën që gratë t’u qëndrojnë larg shërbimeve që ofron komuna. Kjo padyshim që kërkon nga ne që të gjejmë rrugë për t’i bërë shërbimet të aksesueshme si nga burrat ashtu edhe nga gratë.

“Sfidat janë për t’u fituar”

**Liljana Mara, 40 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve,
Nënkryetare e Këshillit të Komunës Kozare,
Kryetare e Forumit të Gruas Demokratike, Kozare.**



Gratë dhe vajzat tona përballen me sfida të vazhdueshme, duke nisur që nga krijimi i familjes. Për vetë kohën që ne jetojmë gratë janë të ekspozuara ndaj shumë rreziqesh dhe dhune që u kanoset, pasi nuk janë të mbrojtura edhe nga ligji. Shpresoj që një ditë edhe zëri i tyre të dëgjohet dhe të mbështetet fort nga të gjithë. Çdo grua dhe vajzë që ka dëshirë dhe vullnet t’i futet rrugës së politikës nuk duhet të ketë frikë të thotë fjalën e vet dhe të shprehë mendimin për çdo problem që e shqetëson. Ato në radhë të parë duhet të guxojnë të ecin përpara. Këto arritje vijnë duke u mbështetur së pari te familja pasi pa mbështetjen e saj nuk mund të arrijnë asgjë. Duhet të guxojnë të dalin jashtë mentalitetit të jetës sidomos në fshat ku sfida është edhe më e madhe. U uroj me gjithë zemër të gjitha grave dhe vajzave që kanë dëshirë dhe vullnet të merren me politikë, të vazhdojnë rrugën e nisur dhe të kemi një përfaqësim më të lartë në parlamentin shqiptar.

“Mbështetuni tek vetja dhe ecni në rrugën që e ndërtoni vetë me kujdes dhe përkushtim”

**Ivana Shtylla, 47 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve, agronome,
Zëvendës kryetare e Komunës Mollaj.**



Pozicionet në të cilat unë kam arritur kanë ardhur jo lehtësisht dhe jo në mënyrë të rastësishme, por duke respektuar parimet e mia personale dhe profesionale: vendosmëria, besimi në atë ç’ka kërkoj tek vetja, puna e ndershme, studimi për rritjen profesionale në çdo aspekt dhe fushë të veprimtarisë së njësisë vendore, puna pa limite kohore për rritjen dhe përmirësimin e imazhit të njësisë vendore, e përmirësimin e jetës sociale dhe ekonomike të komunitetit tonë.

Puna me gratë e komunës ka qenë pjesë e rëndësishme e punës time, të cilën e kam kryer me përkushtimin maksimal dhe asnjëherë me ngjyrimet partiake por duke i parë gratë dhe vajzat si forcën kryesore lëvizëse dhe zhvilluese në jetën familjare dhe atë shoqërore, si progresin, si promotorin e çdo ndryshimi. Mesazhi im për të gjitha vajzat e gratë e reja të cilat duan të ecin drejt të ardhmes së tyre është: jini vetvetja, mbështetni progresin për të arritur atë ç’ka është më e mira për ju, familjen tuaj, shoqërinë ku jetoni. Mos u tërhiqni përpara asnjë vështirësie sepse çdo e tillë mposhtet përpara vullnetit dhe punës së gjinisë femërore.

“Kam trokitur në çdo derë dhe kam takuar çdo banor të komunës time për të dëgjuar nga afër hallet dhe problemet e tyre”

**Shaqe Marinaj, 48 vjeç, bashkëshorte,
Avokate,
Anëtare e këshillit të komunës Shënkoll,
Kryetare e Seksionit të PD dhe Kryetare e Lidhjes
Demokratike të Gruas për Komunën Shënkoll.**



Me njohuritë e fituara nga pjesëmarrja në shumë trajnime mbi përfaqësimin e grave në politikë dhe eksperiencën e fituar gjatë fushatave elektorale në vite, kandidova me dinjitet dhe u zgjodha anëtare e këshillit të komunës në zgjedhjet vendore të vitit 2011, duke u renditur e treta në listë. Sot jam pjesë e këtij këshilli ku ngre zërin në mbrojtje të qytetarëve e sidomos të të rinjve e grave, dhe kontribuoj në rritjen e përfaqësimit të grave në qeverisjen vendore.

“...vetëm me punë dhe rritje profesionale arrihet gjithçka dhe shkallët e karrierës ngjiten një e nga një dhe jo menjëherë se kjo bën që të rrëzohesh shpejt!”

**Merita Tafa, 44 vjeç,
bashkëshorte dhe nënë e një fëmije,
Shefe e Zyrës së Taksave në Komunën Katundi Ri.**



Aktivizimi im politik filloi që me lëvizjen studentore të dhjetorit 1990. Kam qenë pjesë e forumeve të grave demokrate. Që nga tetori 1992, me organizimin e funksionimin e ri të pushtetit vendor e deri më sot punoj në komunën Katundi Ri në Durrës, ku kam ushtruar detyra të rëndësishme të qeverisjes vendore. Gjatë gjithë kësaj periudhe kam marrë pjesë në trainime të ndryshme, nga organizata e institucione shtetërore e private, vendase e të huaja. Jam përkushtuar që detyrat e ngarkuara t'i kryej me korrektësi dhe në respekt të ligjit. Falë punës e përkushtimit, si dhe studimit të vazhdueshëm karriera ime e filluar në vitin 1991 ka ardhur gjithnjë në rritje.

Politika shqiptare duhet të zhvillohet vetëm me njerëz të ndershëm, korrektë dhe të përkushtuar në shërbim të komunitetit dhe jo me njerëz mediokër e jo profesional.

Vajzave e grave të reja u them se vetëm me punë dhe rritje profesionale arrihet gjithçka dhe shkallët e karrierës ngjiten një e nga një dhe jo menjëherë se kjo bën që të rrëzohesh shpejt!

“Nuk jemi qytetare të dorës së dytë, jemi gjysma e popullsisë së botës”

**Etleva Mezini, bashkëshorte dhe nënë e një fëmije,
Përgjegjëse e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve
dhe Barazinë Gjinore në Komunën Shushicë,
Kryetare e Forumit të Gruas së Partisë Socialiste në
Shushicë,
Nënkryetare e Forumit të Gruas së Partisë Socialiste
në Elbasan.**



Kam jetuar për një periudhë 9 vjeçare në emigracion. Atje pashë që gratë dhe vajzat shqiptare kryenin punë shumë të vështira dhe trajtoheshin si qytetare të dorës së dytë. Kjo jetë me vështirësi atje më bëri të mendoj se pritshmëritë e mia ime për të ardhmen nuk ishin këto, e duke dashur që të isha sa më e dobishme për familjen time vendosa të ndjek studimet e larta.

Duke dashur të jap kontributin tim në komunitet mendova të angazhohem në jetën politike duke u bërë anëtare e Partisë Socialiste, kryetare e forumit të gruas në komunën Shushicë dhe nënkryetare në qarkun e Elbasanit.

Gratë dhe vajzat përbëjnë gjysmën e popullsisë në të gjithë botën, dhe duke konsideruar këtë fakt (këtë e dinë tashmë edhe burrat), ne duhet të jemi të ndërgjegjshme për rolin që luajmë në komunitet dhe përgjegjësinë që kemi. Ne jemi ato që duhet të kujdesemi për familjen, fëmijët, tokën, bagëtitë dhe po te shikojmë një 24 orë që kalon gruaja dhe 24 orë të një burri në zonat rurale, do të shikojmë se gruaja është ajo që punon deri në 18 orë ndërsa burri 8-9 orë në ditë.

Ashtu siç e shohim rolin shumë të rëndësishëm që luajmë në familje, duhet të kuptojmë se kemi një rol po kaq të rëndësishëm në komunitet. Pra, duhet të fuqizohemi e të ndërgjegjësohemi, të marrim sa më shumë informacion e të përgatitemi vetë dhe të jemi të afta të përgatitim edhe fëmijët tanë, për përballimin e sfidave dhe rreziqeve në një demokraci në zhvillim dhe në një shoqëri në rritje të vazhdueshme. Nuk duhet të mendojmë për asnjë çast se roli ynë politik dhe në komunitet nuk vlen apo nuk është i rëndësishëm.

Ne kemi gra dhe vajza aktive në jetën politike, jo vetëm duke votuar por që janë të vëmendshme ndaj atyre që kanë zgjedhur si përfaqësues të tyre në pushtetin vendor dhe qendror.

Në komunë kemi 29 punonjës ku 8 janë gra, gjithashtu kemi edhe një grua anëtare të këshillit të komunës. Nuk mund të themi se është një shifër e kënaqshme por shpresojmë që të rritet në të ardhmen.



Unë kam patur dhe vazhdoj të kem bashkëpunim me shoqata që operojnë në qytetin e Elbasanit të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen dhe fuqizimin e rolit të gruas në zonat rurale dhe urbane, nëpërmjet takimeve, trainimeve e projekteve të ndryshme.

Unë do të vazhdoj ta ushqej këtë bashkëpunim të mirë me të gjitha OJFtë dhe institucionet. Gjithashtu besoj dhe shpresoj se do të kem edhe mbështetjen e të gjitha nënave, grave dhe vajzave në mënyrë që të adresojmë problemet dhe shqetësimet e komunitetit ku jetojmë.

